



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:191975
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05800405

K.DH.Shk II.nr. 880/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit “DLD Group” SH.P.K., me NUI:810841636, me seli në Prishtinë, Rruga “Perandori Justinian” nr.25, Pejton, përfaqësuar sipas autorizimit nga Avdullah Hoti Avokat nga Fushë Kosova, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, Rruga “UÇK”, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.1440/23 të datës 30.11.2023, me datë 10.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr. 1440/23 të datës 30.11.2023, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbartimit 618/23, i lejuar me datë 24.08.2023, ANULOHET Urdhri përmbartimor P.nr. 618/23, i lejuar me datë 24.8.2023, nga Përmbartuesi Privat Irfan Kërçagu.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1440/23 të datës 30.11.2023, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 618/23, i lejuar me datë 24.8.2023, nga Përmbarruesi Privat Irfan Kërçagu, dhe Urdhri Përmbarrimor P.nr. 618/23, i lejuar me datë 24.8.2023, nga Përmbarruesi Privat Irfan Kërçagu, mbetet ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe asaj përmbarrimore, konstatimit të gabuar apo jo të plote të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet apo ndryshohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 1440/23 të datës 30.11.2023

Kreditore nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditore "DLD Group" SH.P.K., ka paraqitur propozim për përmbarrim P.nr.618/23 të datës 24.08.2023, me të cilin ka lejuar përmbarrimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr. 2022/0020 të datës 17.08.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t'i paguaj kreditorit borxhin në shumë të përgjithshme prej 1,000.00 €, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarrimore, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, me ndalimin dhe transferimin e të hollave në llogarinë e kreditorit, regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme deri në vlerën e borxhit.

Debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ku ka theksuar ndër të tjerash se urdhri përbarimor është i pabazuar, i palejueshëm dhe i paqëndrueshëm, kjo për faktin se i njëjti nuk është i mbështetur në asnjë dispozitë ligjore dhe se provat të cilat i janë bashkëngjitur propozimit për përbarim nuk janë dokumente të besueshme. Tutje ka theksuar se fatura e cila i është bashkëngjitur propozimit për përbarim është në kopje, e njëjta nuk mund të jetë objekt përbarimi. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të abrogohet urdhri për përbarim

Kreditori në përgjigjen në prapësimin të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim. Tutje ka theksuar se fatura është dorëzuar dhe protokolluar në origjinal. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, të aprovoj urdhrin përbarimor si dhe të detyrohet debitori që t'i paguaj shpenzimet e procedurës, dhe atë për përpilimin e propozimit për përbarim shumë prej 104.00 €, për përpilimin e përgjigjes në prapësim shumë prej 104.00 €

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të pretendimeve palëve, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 2022/0020 e datës 17.08.2022, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe është i përshtatshëm për përbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me neni 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë, vlerëson - Faturën Nr. 2022/0020 të datës 17.08.2022, e cila faturë i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori si dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë ka vlerësuar pretendimet e debitorit i cili ka theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk është pranuar nga ana e debitorit, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara, ngase, në rastin konkret rezulton se Fatura Nr. 2022/0020, në vlerë prej 1,000.00 €, është lëshuar nga ana e kreditorit me datën 17.08.2022 dhe e njëjta është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori e cila evidentohet përmes vulës së protokollit Nr. 10-410/02-0218568/22 të datës 11.10.2022.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk mund ta pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë pasi gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ashtu që edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e shkallës së dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Po ashtu Dhoma e Shkallës së Dytë e vlerëson se dokumenti – Fatura, në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se kreditori me asnjë provë nuk ka dëshmuar se fatura është dorëzuar te debitori, pasi e njëjta nuk është protokolluar në zyrën e pranimit të debitorit – Komuna e Prishtinës nuk mban vulën e pranimit - protokollimit, si dhe nuk është nënshkruar nga ana e debitorit, nga rezulton se si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbartim. Andaj, duke qenë se debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, si e tillë, e njëjta nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm

dhe nuk ka tipare të përmbareshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Dhoma e Shkallës së Dytë gjen se dokumentet, përkatësisht fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbareshmërisë, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se fatura në fjalë është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se e njëjta është pranuar nga debitori, për arsye se fatura nuk është protokolluar në zyrën e pranimit të debitorit – Komuna e Prishtinës nuk mban vulën e pranimit - protokollimit, Ndërsa, në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmojë se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit. Rrjedhimisht, fatura e lëshuar nga kreditori, mirëpo e papranuar nga debitori përbën dokument të njëanshëm dhe, si e tillë, nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm- fatura, e mbi bazën e të cilit Përmbareshmërisë Privat ka lejuar përmbareshmërisë, nuk ka tipare të përmbareshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e Përmbareshmërisë Privat duhet të anulohet.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjënë se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të aprohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe urdhri për lejimin e përmbareshmërisë nga ana e Përmbareshmërisë Privat Irfan I. Kërçagut të anulohet.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K. DH.Shk II.nr. 880/24 me datë 10.06.2024

**Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti**